

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia:	Nr. Prot.: 198/2018
Unit:	Prot. No.:
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqëve:	Data: 02.05.2018
No. of pages: - 03 -	Datum:
Br. stranica:	Pristinë/s



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 198/2018

PËR: Institucionet Publike Shëndetësore të Republikës së Kosovës
NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci., Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)
LËNDA: Qarkore informative lidhur me licencimin e mjekëve dhe Edukimin e Vazhdueshëm Profesional (EVP)
Datë: 02 maj 2018

Të nderuar drejtues të institucioneve publike dhe private shëndetësore,

Në drejtim të ushtrimit të funksioneve publike që i janë besuar Odave të Profesionistëve Shëndetësor në bazë të dispozitave të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, në bazë të rekomandimit të Komisionit për Hartimin e Planit të Veprimit në procesin e bartjes së kompetencave publike, Ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, ka nxjerrë vendimin me të cilin ka formalizuar bartjen e kompetencës së Licencimit dhe Rilicencimit të Mjekëve dhe Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.

Meqnëse në Vendimin nr. 05-2655, dt. 26.04.2018, respektivisht në dispozitivin e këtij vendimi është përcaktuar bartja e kompetencave të tilla me karakter publik, jemi koshient që në shërbim të këtij procesi të rëndësishëm dhe me përgjegjësi të madhe të shfrytëzojmë rastin që t'i njoftojmë të gjithë mjekët lidhur me detyrimet e tyre karshi procedurave që në të ardhmën do të zhvillohen pranë organeve kompetente të OMK-së.

Rilicencimi sipas afatit të Vendimit të MSh-së – Siç jeni në dijeni, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar validitetin e licencave të skaduar, deri më 30 qershor 2018. Ky afat nënkupton që me kalimin e kohzgjatjes së tillë të gjithë mjekët me licencë të skaduar duhet të plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, e që kjo nënkupton përmbushjen kuotës së pikëve të edukimit të vazhdueshëm profesional, duke i valorizuar aktivitetet e tilla me pikë të cilat përmbushin kushtin e rilicencimit krahas kushteve të tjera të nevojshme për rilicencim.

Kjo nënkupton se në mungesë të pikëve të mjaftueshme, **rilicencimi nuk do të jetë i mundshëm dhe kërkesa e tillë do të refuzohet.**

Në këtë drejtim, udhëzojmë të gjitha institucionet publike dhe private që sa më shpejt të identifikojnë mjekët e punësuar nga ta dhe të cilët me datë 1 korrik 2018 bien ndesh me Vendimin e Ministrit dhe dispozitat ligjore mbi obligimin për Licencim dhe rilicencim.

Dukem pasur parasysh se OMK nuk do të zgjasë më këtë afat, poashtu në mënyrë që mjekët të cilët bien ndesh me këtë, rekomandojmë që të gjitha institucionet të bëjnë urgjentisht organizimin e punëtorive dhe ligjeratave të rregullta për këta mjek.

Anëtarësimi i obligueshëm në OMK- Ndër kushtet themelore për licencimin dhe rilicencimin e mjekëve është anëtarësimi i tyre në OMK. Detyrimi i tillë buron nga dispozitat e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 8 paragrafët 1 dhe 2. Të gjithë mjekët, të përgjithshëm dhe specialist, specializant e doktorët e mjekësisë, të cilët aplikojnë për tu pajisur me licencë detyrimisht duhet të parashetrojnë formularin për anëtarësim. Përndryshe, kërkesa e tyre refuzohet dhe licencimi i tyre juridikisht është i pamundshëm.

Prandaj, duke marrë parasysh faktin se regjistrimi dhe anëtarësimi në OMK ka filluar në muajin Janar 2018 , OMK do të detyrohet të ndërmarr masa ligjore bazuar në Statutin e OMK , gjegjësisht Nenin 14 dhe 15 duke u bazuar në Nenin 17, Paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.

Vërejtje: Ushtrimi i veprimtarisë mjekësore të palicencuar (mosposedimi i licencës valide) përbën shkelje të rëndë ligjore. Veprimtaria e tillë konsiderohet se ushtrohet jashtë autorizimeve ligjore dhe si e tillë përbën element të veprës penale Ushttrim i kundërligjshëm dhe i pautorizuar i veprimtarisë mjekësore nga Neni 262 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Po ashtu shkelja e tillë paraqet shkelje të rëndë disiplinore, që nënkupton se mjeku i cili bën shkelje të tillë mund të jetë subjekt i procedurës disiplinore dhe për shkeljen e tillë mund të shqiptohet masa disiplinore e paraparë me Nenin 25 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, respektivisht gjoba në shumë prej 1,000.00 € (njemijë euro) deri në 3,000.00 € (tremijë euro).

Obligimi për respektimin e normimeve të mësipërme është edhe nën përgjegjësinë e menaxhmenteve shëndetësore, duke pasur parasysh detyrimin për zbatimin e legjislacionit në fuqi nga fusha shëndetësore.

UDHËZOHEN: Të gjitha institucionet shëndetësore që këtë qarkore informatve ta bëjnë të qasshme për informim për të gjithë mjekët e punësuar pranë institucionit përkatës. Njoftimi i tillë do të duhet të bëhet në çfarëdo mënyre e cila do të mundësojë informimin e mjekëve për përmbajtjen e tillë.

Po ashtu, institucionet të drejtojnë mjekët që të kontaktojnë OMK-në në adresë: ***Rr. Kosta Novakoviç p.n. Kontenieri nr. 3, Zyra nr. 214, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.***

Dhe numrave kontaktues: 038 213 872, Centrix : 038 200 24 188 dhe mobil: 049 872 300; apo

Përmes postës elektronike: odaemjekeve@outlook.com

Vërejtje: Kësaj shkrese do t'i bashkëngjitet Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, nr. 05-2655, dt. .

Me respekt,

Prishtinë, 02 maj 2018

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, M. Sci.

